

maj 2010

gap

monitor

i vendimeve të Qeverisë së Kosovës

- Qeveria i kërkon dividendën PTK-së dhe i thotë jo operatorit të tretë të telefonisë mobile;
- Ndahen mjete për fillimin e projektit 'Hidrocentrali Zhur'
- Qeveria kërkon rishikimin e Modelit të Tregut të energjisë elektrike
- Rritje pagash prej 30 euro për shërbyesit civil



Gjatë muajit maj, Qeveria e Kosovës ka mbajtur tri mbledhje të rregullta. Në këto mbledhje janë marrë gjithsejtë 30 vendime. Vendimet e marra kanë të bëjnë me miratim të projektligjeve (6 vendime), miratim të akteve nënligjore (1 vendim), ndarje të mjeteve financiare (3 vendime), Universitetin e Prizrenit (2 vendime), postën dhe telefoninë mobile (2 vendime), miratim dokumentesh dhe strategjish (3 vendime), ndryshim të Strategjisë Legjislative (1 vendim), emërim të anëtarëve në borde (3 vendime), etj.

Për të dytin vit radhazi, Qeveria e Kosovës, me vendim ekzekutiv, ka marrë dividendën nga PTK-ja. Pas miratimit të Projektligjit për Gjykatat në muajin mars, këtë muaj Qeveria ka miratuar edhe tri projektligje nga fusha e gjyqësisë, të cilat janë evidentuar si sfida në Raportin e Progresit të 2008 dhe 2009. Nga Strategjia legjislative për 2010 është larguar një projektligj dhe tani kjo strategji ka 126 projektligje. Përkundër miratimit të gjashtë projektligjeve, Qeveria e Kosovës edhe këtë muaj ka mbetur mbrapa me miratimin e projektligjeve që parashihen në Strategji Legjislative për 2010. Në pesë mujorin e parë të këtij viti janë miratuar 26 projektligje, apo 20.6% e Strategjisë Legjislative 2010.

Raportet për të gjitha vendimet e marra gjatë muajit maj të 2010 mund t'i gjeni në GAP Monitor, i 17 me radhë dhe i pari me dizajnë të ri. Këtë GAP Monitor dhe raportet për vendimet, të shoqëruar edhe me komentet e lexuesve dhe opinione, mund ta lexoni edhe duke klikuar në www.gapmonitor.org.

Përmbajtja:

1. Miratohen edhe tri projektligje të shumëpritura për gjyqësinë
2. Udhëzimi administrativ që ndryshon Ligjin
3. Qeveria i kërkon dividendën PTK-së dhe i thotë jo operatorit të tretë të telefonisë mobile
4. Ndahen mjete për fillimin e projektit 'Hidrocentrali Zhur'
5. Zgjerohen magjistralet – merret vendim për shpronësimin e pronave
6. Kompletohet Bordi Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit dhe emërohet Këshilli për Planifikim Hapësinor
7. Qeveria aprovon Planin Zhvillimor të Universitetit të Prizrenit
8. Qeveria ndihmon financiarisht shoqatën e matematikanëve dhe deputetin Ali Lajçi
9. Miratohet Projektligji i ri për Qasje në Dokumentet Publike
10. Qeveria i Propozon Kuvendit emrat për Komisionin Rregullativ të Prokurimit
11. Themelohet Komisioni Kombëtar për Refugjatë
12. Qeveria kërkon rishikimin e Modelit të Tregut të energjisë elektrike
13. Shtohet stafi i Departamentit të Trashëgimisë Kulturore
14. Pasaporta diplomatike edhe për Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese dhe familjen e tij
15. Rritje pagash prej 30 euro për shërbyesit civil
16. Miratohet propozimi i MEF për heqjen e ndëshkimeve për borxhet tatimore
17. Ndryshohet dhe plotësohet Strategjia Legjislative 2010
18. Miratohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit
19. Përpjekje për integrimin e komunitetit RAE – themelohet Komuniteti Drejtues Ndërinstitucional
20. Themelohet Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave
21. Miratohet Projektligji për themelimin e Sistemit të Depozitave për Institucionet Financiare të Kosovës
22. Miratohet me ndryshime Rregullorja për themelimin e Zyrës për të Drejtat për Pronën Intelektuale
23. Miratohet plotësim – ndryshimi i Strategjisë për Ri-integrimin e personave të riatdhesuar

Miratoohen edhe tri projektligjet e shumëpritura për gjyqësinë

Projektligjet e miratuara në Qeveri, janë përgatitur nga Ministria e Drejtësisë që në mars 2009. Mirëpo Qeveria ka shtyrë miratimin e tyre për më shumë se një vit.

Në muajin mars të këtij viti, Qeveria e Kosovës miratoi Projektligjin për Gjykatat, hyrja në fuqi e të cilit më në fund do të largoj nga zbatimi edhe një ligj të aplikueshëm që në kohën e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës - Ligjin mbi Gjykatat e Rregullta të ish Republikës së Jugosllavisë.

Këtë muaj Qeveria e Kosovës ka miratuar edhe tri projektligje të rëndësishme nga fusha e gjyqësisë: Projektligjin për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës, Projektligjin për Prokurorinë e Shtetit dhe Projektligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Projektligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës është miratuar në mbledhjen e 124-të më 13 maj 2010, kurse dy projektligjet tjera janë miratuar në mbledhjen e 125-të më 18 maj 2010.

Mirëpo, këto tri projektligje nuk janë dërguar në Kuvend deri me datën 14 qershor 2010. Qeveria nuk i ka bërë publike këto projektligje, me arsyetimin se ato mund të bëhen publike vetëm kur t'i dërgohen zyrtarisht Kuvendit të Kosovës. Mirëpo, kjo rregull nuk bazohet në asnjë akt ligjor. Zyrtarët ligjor në

Ministrinë e Drejtësisë shprehen se që nga marsi i 2009, kur kjo ministri ka dërguar këto projektligje në Kuvend, nuk kanë pasur mundësi që të kenë qasje në ndryshimet dhe plotësimet që janë bërë në to. Andaj edhe nuk i posedojnë projektligjet në formën përfundimtare të miratuara në Qeveri. Sipas tyre, është më se e sigurt se këto projektligje kanë pësuar ndryshime, përndryshe nuk ka pasur arsye që ato të mbahen më shumë se një vit në Qeveri. Qeveria e Kosovës ka pasur presione që në përmbajtjen e Projektligjeve të përfshijë edhe një nga 6 pikat e Dokumentit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së të 12 qershorit 2008, sipas pikës 2 të të cilit “në pjesët e banuara me shumicë serbe, mund të themelohen gjykata të veçanta të cilat operojnë sipas Rezolutës 1244 të KS të OKB.”

Por deri më tani, përderisa Qeveria ende nuk ka bërë publike këto projektligje dhe nuk i ka dërguar në Kuvend, nuk mund të thuhet me saktësi se çfarë është përmbajtja e tyre. Mos miratimi i këtyre ligjeve ka qenë objekt kritikash edhe në Raportet e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për tri vitet e fundit. Gjithashtu, këto projektligje ndodhen në strategjitë legjislative të Qeverisë që nga viti 2008.

Udhëzimi administrativ që ndryshon Ligjin

Sipas rregullit, aktet nënligjore shërbejnë për të lehtësuar zbatimin e ligjit, por jo për të ndryshuar përmbajtjen e tij.

Më 26 maj, në mbledhjen e 126-të Qeverisë së Kosovës, është marrë vendimi 2/126 për miratimin e Udhëzimit Administrativ për Nënshkrimin e Kontratave Publike me Vlerë të Mesme dhe të Madhe. Sipas këtij udhëzimi, ndryshe nga deri më tani ku të gjitha kontratat publike janë nënshkruar nga shefat e prokurimit, tani e tutje kontratat në vlerë mbi 10.000 Euro do të nënshkruhen edhe nga sekretari i përhershëm i ministrisë dhe nga vetë udhëheqësi politik i organizatës qeveritare (ministri, kryetari i komunës, etj.). Sipas Qeverisë, ky ndryshim në aktivitetet e prokurimit bëhet me qëllim të qartësimit të përgjegjësiave lidhur me nënshkrimin e kontratave.

Mirëpo, ndryshimi me akt nënligjor i Ligjit për Prokurorimin Publik, nuk është konform ligjeve në fuqi. Sipas rregullit, aktet nënligjore shërbejnë për plotësimin e akteve primare ligjore, por asesi nuk guxojnë të bien në kundërshtim me vetë përmbajtjen e ligjit. Neni 24 i Ligjit për Prokurimin Publik specifikon se “Kontrata publike e nënshkruar nga kushdo përveç Zyrtarit Prokurues të autoritetit kontraktues është e pavlefshme dhe e pazbatueshme.” Nëse Qeveria dëshiron që të ndryshoj këtë pjesë të Ligjit për Prokurorimin Publik, këtë mund ta bëjë vetëm përmes Ndryshimit dhe Plotësimit të Ligjit për Prokurorim Publik, i cili duhet të miratohet nga Kuvendi i Kosovës.



Qeveria i kërkon dividendën PTK-së dhe i thotë jo operatorit të tretë të telefonisë mobile

Brenda dy viteve, përmes dy vendimeve të ndryshme, Qeveria i kërkon PTK-së dividendën në vlerë prej 280 milion euro.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Qeveria e Republikës së Kosovës u bë ushtrues i ligjshëm i të drejtave të aksionarit në Ndërmarrjen Publike "PTK" sh.a. dhe që atëherë gëzon të drejtën që të kërkojë nga kjo ndërmarrje deklarimin dhe pagesën e dividendës për aksionarin. Një vendim i tillë është marrë vitin e kaluar, më 14 korrik 2009, kur Qeveria e Kosovës kërkoi nga PTK të paguajë dividendën në shumë prej 200 milion euro. Një pagesë e tillë i është kërkuar PTK-së edhe në mbledhjen e 124-të të Qeverisë, të mbajtur më 13 maj 2010, në shumën prej 80 milion euro. Pos kësaj shume, kjo ndërmarrje publike urdhërohet të ngrijë në mënyrë gjithëpërfshirëse nivelin e pagave dhe të punësimit të punonjësve të rinj dhe të mos vazhdojë ose përtërijë kontratat ekzistuese të punës përtej datës 31 dhjetor 2010. Krahas këtij vendimi, PTK-së i kërkohet që të mos zbatojë asnjë projekt kapital ose shpenzim të ri, i cili nuk është paraparë në planin e biznesit të aprovuar nga aksionari - Qeveria. Për zbatimin e këtij vendimi, përgjegjës do të jetë Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave në rolin e Kryesuesit të Komisionit Ndër-Ministror për Ndërmarrjet Publike.

Në po këtë mbledhje, Qeveria e Kosovës i ka rekomanduar Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit (ART) që të mos jap licencë për operatorin e tretë të telefonisë mobile në Kosovë për pesë vitet e ardhshme. Një rekomandim i tillë është dhënë pas konstatimit të Qeverisë se futja e një operatori të tretë në tregun kosovar do ta ulte ndjeshëm dhe në mas të madhe vlerën e PTK-së dhe do të ndikonte ndjeshëm në procesin e pjesëmarrjes së sektorit privat në PTK. ART është njoftuar vetëm përmes medieve rreth këtij rekomandimi, kurse edhe pas dhjetë ditëve ajo nuk ka pranuar zyrtarisht nga Qeveria këtë rekomandim. Megjithatë, vendimi për futjen e operatorit të tretë përfundimisht është nën kompetencat e ART-së, kompetencë të cilën ia siguron Ligji për Telekomunikacionin që e konsideron ART-në si trup të pavarur që i raporton Kuvendit. Sipas zyrtarëve të saj, ART mbetet me qëndrimin se konkurrenca rezulton në përmirësimin e shërbimeve për konsumatorin.

Ndahen mjete për fillimin e projektit 'Hidrocentrali Zhur'

Qeveria e Kosovës ka aprovuar kërkesën e Ministrisë së Energjisë dhe Minierave (MEM) për ndarjen e mjeteve për fillimin e projektit 'Hidrocentrali Zhur'. Në mbledhjen e mbajtur më 13 maj 2010, Qeveria e Kosovës aprovoi kërkesën për ndarjen e 160,000 euro për themelimin e Njesisë për Menaxhimin e Projektit dhe Këshilltarëve të Transaksionit. Megjithatë, sipas MEM kërkesa për 160.000 euro ka qenë vetëm për Njësine për Menaxhimin

e Projektit, përderisa për Këshilltarët e Transaksionit MEM kishte kërkuar 350.000 euro. Pra, sipas zyrtarëve të MEM, është bërë një lëshim në përpilimin e vendimit të Qeverisë, për të cilin do të kërkohet përmirësim. Mjetet e aprovuara do të shpenzohen për kontraktimin e një menaxheri të projektit dhe pesë inxhinierëve. Pas pesë apo gjashtë muajve pritet të angazhohen edhe ekspertë të tjerë. Kjo zyrë pritet të fillojë së funksionuari në

muajin gusht. Deri më tani, përveç studimit të fizibilitetit, MEM nuk ka përpiluar ndonjë plan apo strategji për 'Hidrocentralin Zhur'. Ekspertët supozojnë se në Kosovë mund të ndërtohen 18 hidrocentrale, ku ai i Zhurit pritet të jetë një ndër të parët dhe me kapacitetin më të madh. Ky hidrocentral që pritet të ndërtohet në Zhur të Prizrenit mund t'i sigurojë sistemit elektroenergjetik të Kosovës fuqi variable prej 305 MW, me prodhim mesatar vjetor 398 GWh.

Zgjerohen magjistralet – merret vendim për shpronësimin e pronave

Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e saj të 124-të, vendosi të miratojë kërkesën për shpronësimin e pronave me qëllim të zgjerimit të magjistrales Prishtinë-Pejë dhe Prishtinë-Mitrovicë. Shpronësimi i pronave do të bëhet përgjatë rrugës M9 nga Fushë Kosova deri në Arllat, rrugës M2 nga

Prishtina deri në Mitrovicë. Ky vendim është marr në përputhje me Ligjin për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme. Ndërkaq, vlera e kompensimit të këtyre pronave do të përcaktohet sipas kategorive përkatëse nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave e mbështetur nga

Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit dhe Komunitat në territorin e të cilave kalojnë zonat kadastrale. Zgjerimi i këtyre rrugëve ishte një ndër premtimet e bëra nga PDK gjatë fushatës së zgjedhjeve të vitit 2007.



Kompletohet Bordi Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit dhe emërohet Këshilli për Planifikim Hapësinor

CV-të e katër kandidatëve i janë dërguar kuvendit për shqyrtim dhe aprovim.

Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e saj të 124-të, me vendimin 8/124 për anëtarë të Bordit Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit i rekomandoi Kuvendit të Kosovës këta kandidat: Behxhet Mustafa, Sylejman Berisha, Kemail Bislimi, Nysrete Doda – Gashi, Tush Markaj dhe Luan Shllaku. Duke u bazuar në nenin 62 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, Kuvendi i Kosovës emëron Bordin Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit përtë këshilluar Kuvendin dhe Qeverinë për çështje të mbrojtjes së mjedisit. Bordi duhet të përbëhet nga shtatë anëtarë të emëruar nga Kuvendi. Anëtarët e Bordit zgjedhën nga ekspertë dhe shkencëtarë të dalluar në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe nuk mund të jenë të punësuar në Ministri. Bordi është i pavarur nga çdo autoritet tjetër. Detyrat e Bordit janë që të japin mendime

dhe sugjerime për Kuvendin dhe Qeverinë dhe të informojnë publikun për çështjet si:

- gjendjen e mjedisit dhe trendët në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- strategjinë dhe politikën për mbrojtjen e mjedisit dhe koordinimin e tyre me trendët ndërkombëtare;
- harmonizimin mes zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së mjedisit;
- ligjet që rregullojnë mbrojtjen e mjedisit;
- veprimtarinë e ministrive përgjegjëse dhe aktivitetet e komunave në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- iniciativat publike, dhe
- funksione tjera të përcaktuara me ligj.

Në po këtë mbledhje, Qeveria e Kosovës emëroi anëtarët e Këshillit për Planifikim Hapësinor

të përbërë nga: Ruzhdi Pllana; Ylber Vokshi, Ilir Gjinolli, Laura Kusari-Limaj, Xhelal Lloncari, Dervish Qerreti dhe Adem Pajaziti. Duke u bazuar në nenin 7 të Ligjit për Planifikim Hapësinor, ky këshill formohet me qëllim të sigurimit të kushteve për zhvillim të qëndrueshëm dhe të barabartë hapësinor të Kosovës, mbështetjes profesionale dhe shkencore të dokumenteve. Detyrë e këshillit do të jetë dhënia e mendimeve, propozimeve dhe vërejtjeve në dokumentet e planifikimit hapësinor dhe dokumenteve të tjera të përcaktuara me këtë ligj, të cilat i miraton Qeveria ose Kuvendi i Kosovës. Anëtarë të Këshillit nuk mund të jenë zyrtarët, menaxherët, pronarët ose të punësuar tek personat juridikë të cilët i kryejnë punët profesionale të planifikimit hapësinor siç janë arkitektët.

Qeveria aprovon Planin Zhvillimor për Universitetin e Prizrenit

Sipas rekomandimeve në këtë Plan, 'Universiteti i Prizrenit' fillimisht nuk mund të quhet 'Universitet' por vetëm Kolegj. Edhe Ligji për Arsimin e Lartë specifikon se termi 'Universitet' mund t'i jepet vetëm një bartësi të akredituar të arsimit të lartë, që ka të paktën 3.000 studentësh të rregullt, që ofron programe në të paktën 5 fakultete të ndryshme me së paku 600 studentë në secilin.

Vendimi për themelimin e Universitetit të Prizrenit është marr nga Qeveria më 9 tetor 2009, kurse më 12 shkurt 2010 Qeveria i kishte dhënë leje MASHT-it që të angazhojë një kompani konsulente për hartimin e Planit Zhvillimor për Universitetin e Prizrenit. Për këtë, MASHT kishte angazhuar kompaninë gjermane CHE Consult. Kështu, në mbledhjen e 125-të, Qeveria ka aprovuar Planin Zhvillimor për Universitetin e Prizrenit. Sipas këtij plani, viti i parë akademik në Universitetin e Prizrenit duhet të fillojë në tetor 2010, me një numër të studentëve prej 3.000 deri në 5.000. Universiteti parashihet të jetë modern në infrastrukturë, metodologji dhe përmbajtje, i orientuar drejt hulumtimeve. Për fillim universiteti duhet të fillojë funksionin në objektet e Fakultetit të Edukimit në Prizren, derisa të ndërtohen objektet në vendin e ndarë nga komuna. Pasi Universiteti do të fillojë nga zeroja, sugjerohet të quhet Kolegj Universitar, kurse Kolegji post-universitar të themelohet në vitet e ardhshme. Shkak për këtë mund të jetë edhe interpretimi i Ligjit për Arsimin e Lartë që thotë se termi 'Universitet' mund t'i jepet vetëm një bartësi të akredituar të arsimit të lartë, që ka të paktën 3.000 studentë të rregullt, që ofron programe në të paktën 5 fakultete të ndryshme me së paku 600 studentë në secilin. Stafit akademik pritet të ndahet në bazë të departamenteve, ku si fillim sugjerohet të themelohen këto departamente:

- Departamenti i gjuhës dhe përkthimeve;
- Departamenti i Inxhinierisë dhe shkencave kompjuteristike;
- Departamenti i qeverisjes dhe ekonomisë (juridiku, ekonomia, menaxhimi i biznesit, shkencat politike);
- Departamenti i Shkencave të Mjekësisë;
- Departamenti i artëve, shkencave humane dhe shkencave natyrore (përfshirë matematikën).

Plani Zhvillimor sugjeron edhe themelimin e katër Instituteve në vitet në vazhdim, përfshirë Institutin e Teknologjisë Informative (2011), Institutin e

Qeverisjes dhe Ekonomisë (2011), Institutin e Energjisë (2012) dhe Institutin e Hulumtimeve Mjekësore (2012).

Plani flet edhe për metodat që duhet të adoptojë Universiteti për sigurimin e cilësisë. Pritet të adoptohet Sistemi i Bolonjës me tri cikle studimi, kurse shumica e programeve bachelor sugjerohet të jenë katër vjeçare ku të paktën një semestër përbën punën praktike. Studimet master pritet të jenë një vjeçare apo edhe dy vjeçare me gjysmë normë. Departamentet sugjerohet të udhëhiqen nga menaxher të huaj, me titull akademikë Doktoraturë. Sipas këtij Plani, Universitetit të Prizrenit i sugjerohet të gjejë partnerë nga Austria apo Gjermania, Britania apo Irlanda, Shtetet e Ballkanit apo Italia, me qëllim të huazimit të plan programeve mësimore dhe shkëmbimit të studentëve. Gjatë muajit qershor Universiteti i Prizrenit duhet të zgjedh rektorin, i cili më pas bënë përzgjedhjen e stafit akademik. Sidoqoftë, ky plan zhvillimor nuk është përfundimtar, ngase sipas koordinatorit të Universitetit të Prizrenit pranë MASHT, rektori ka të drejtë të ndërhyjë në ndryshimin e këtij plani zhvillimor.

Në po këtë mbledhje, Qeveria ka miratuar kërkesën e MASHT për ndarjen e shumës prej 2 milion euro për programin 'Universiteti i Prizrenit'. Tabela e më poshtme ofron detaje rreth ndarjes së këtij buxheti:

Programi Universiteti i Prizrenit	Shuma e ndarë: 2 milion euro
Të punësuar	95 persona
Paga dhe mëditje	303.272,33 euro
Mallra dhe shërbime	696.027,67 euro
Shpenzime komunale	85.000,00 euro
Shpenzime kapitale	916.700,00 euro

Ndërkaq, sipas parashikimeve buxhetore për vitin 2011 dhe 2012 do të ndahen nga 5 milion euro për Universitetin e Prizrenit.

Qeveria ndihmon financiarisht shoqatën e matematikanëve dhe deputetin Ali Lajçi

Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e saj të 124-të, ndau mjete financiare në shumë prej 11 mijë euro për mbulimin e shpenzimeve për shoqatën e matematikanëve të Kosovës. Kjo shoqatë u formua në gusht të vitit 2008 dhe ka selinë në Prishtinë. Veprimtaritë e kësaj shoqata janë: organizimi dhe mbështetja e seminareve, konferencave, forumeve apo formave të tjera të organizimeve publike; publikimi dhe blerja e revistave, librave e materialeve të tjera shkencore e profesionale; bashkëpunimi i nevojshëm me organizmat,

shoqatat, institucionet dhe individët brenda dhe jashtë vendit; organizimi dhe mbështetja e aktiviteteve të ndryshme (si gara, shkolla sezonale, seri kursesh, etj. Matematika vlerësohet si një nga fushat ku më së shumti vërehet mungesa e stafit të kualifikuar dhe një interesim i ulët për studimin e kësaj fushe. Andaj mbështetja financiare dhe stimulimi i të rinjve, mund të ndikojnë që kjo fushë studimore të ketë vëmendjen e duhur nga institucionet, profesionistët dhe studentët.

Në po këtë mbledhje, Qeveria e Kosovës aprovoi kërkesën e deputetit Ali Lajçi për mbulimin e shpenzimeve të shërimit. Mjetet ndahen nga rezervat e Qeverisë për shpenzime të paparashikuara dhe derdhen në xhirollogarinë bankare të Ali Lajçit pas sjelljes së faktuarve të shpenzimeve. Rikujtojmë se në dhjetor të vitit të kaluar, Qeveria e Kosovës në mbledhjen e saj të 96-të u pat ndarë mjete për shërim edhe të ndjerit Fadil Ferati dhe Kryetarit aktual të Komunës së Ferizajt Bajrush Xhemjali.

Miratohet Projektligji i ri për Qasje në Dokumente Publike

Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e saj të 13 majit, ka miratuar Projektligjin për Qasje në Dokumente Publike, i cili pas miratimit në Kuvendin e Kosovës do të zëvendësojë Ligjin për Qasje në Dokumente Zyrtare, i cili është në fuqi nga viti 2003. Ndryshimi i emërimit nga "dokumente zyrtare" në "dokumente publike" nuk ka ndonjë ndikim në përmbajtje, ngase që në hyrje të projektligjit thuhet se "dokument publik nënkupton dokument zyrtar".

Përmbajtja e projektligjit nuk parashihet që të ndryshoj në masë të madhe nga përmbajtja e ligjit aktual në fuqi. Ndryshimi më i rëndësishëm që parashihet të bëhet është shkurtimi i kohëzgjatjes për përgjigje në kërkesat për qasje në dokumente publike nga 15 ditë pune sa është tani, në 15 ditë, duke llogaritur edhe ditët kur nuk punohet. Kjo nënkupton se përgjigja pritët të jepet për 4-6 ditë më shpejt. Gjithashtu, parashihet të shkurtohet edhe afati kohor për

përgjigje të autoriteteve publike ndaj kërkesave konfirmuese, i cili nga 15 ditë punë do të ulet vetëm në 7 ditë.

Pjesa tjetër e projektligjit në masë të madhe përsërit atë që vetëm është në fuqi. Problemi me Ligjin për Qasje në Dokumente Zyrtare, i cili është në fuqi që nga 2003, nuk ka qenë përmbajtja e tij por zbatueshmëria. Andaj, zëvendësimi i ligjit aktual me një ligj të ri, të riemërtuar, nuk është zgjidhja për problemin e qasjes në dokumente zyrtare (publike).

Qeveria i propozon Kuvendit emrat e kandidatëve për Komisionin Rregullativ të Prokurimit

Për 6 muaj Komisioni Rregullativ i Prokurorit ka funksionuar me mandat të skaduar.

Në mbledhjen e 125-të, Qeveria e Kosovës për Kryetar dhe anëtarë të Komisionit Rregullativ të Prokurimit i propozoi Kuvendit të Kosovës këta kandidatë: Safet Hoxha – kryetar, Ilaz Duli - anëtar dhe Silvana Nikolcevic - anëtare. Bazuar në Ligjin për Prokurimin publik, anëtarët e KRPP-së duhet të përmbushin njërën nga kriteret si në vijim: ai/ajo të jetë jurist, ekonomist ose profesionist tjetër me diplomë universitare në fushën e inxhinierisë ose arkitekturës dhe të ketë përvojë të konsiderueshme në ekzekutimin e projekteve të punëve. Për dallim nga mandati i kaluar kur KRPP-ja përbëhej nga pesë anëtarë, por me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Prokurim Publik në Kosovë 02/L-99, neni 86.1, në shkurt të vitit 2007, KRPP-ja tani do të përbëhet prej tre (3) anëtarëve. Mandati mbetet i njëjtë prej pesë viteve, ndërsa riemërimi i tyre mund të bëhet vetëm një herë.

Themelohet Komisioni Kombëtar për Refugjatë

Në Ligjin për Azil, i cili ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008, thuhet se Komisioni Kombëtar për Refugjatë duhet të formohet nga Qeveria e Kosovës sipas propozimit të Ministrit së Punëve të Brendshme. Qeveria mori vendim për themelimin e këtij komisioni në mbledhjen e saj të 125-të, të mbajtur më 18 maj 2010. Ky komision do t'i ketë gjithsejtë 11 anëtarë duke përfshirë Kryetarin e Komisionit si dhe zëvendësin e tij. Pjesë e këtij komisioni janë: përfaqësuesi i MPB-së i cili është edhe kryetar i komisionit, i ZKM-së, që është edhe zëvendëskryetar i komisionit, pastaj përfaqësuesi i MPMS-së, i MAPL-së, i MD-së, i MPJ-së, i MEF-it, i MASHT-it, i

UNHCR-së, i KMDLNJ-së dhe i QKMRT-së. Roli i këtij komisioni është të shqyrtojë ankesat që mund të vijnë nga palët e interesuara për të fituar statusin e refugjatit. Fillimisht kërkesa për azil dërgohet tek Zyra për Azil që funksionon në kuadër të MPB-së. Nëse vendimi i Zyrës për Azil është negativ, atëherë pala mund t'ia shtrojë kërkesën këtij komisioni dhe nëse ky komision konstaton që pala është dëmtuar, ai ia kthen kërkesën Zyrës për Azil për rishqyrtim të mëtutjeshëm. Po qe se edhe ky komision konstaton të njëjtën gjë siç ka konstatuar Zyra për Azil, atëherë pala e interesuar mund

të parashtrojë kërkesën për shqyrtim tek organet e gjyqësisë.

Puna e komisionit do të jetë e pavarur dhe kjo përbërje do të ketë mandat dy vjeçar. MPB është e obliguar që të sigurojë hapësirën e nevojshme dhe mbështetjen teknike të nevojshme për vijimin e punës së këtij komisioni. Anëtarët e këtij komisioni do të realizojnë të ardhura mujore prej 200 euro, shumë e cila do të mbulohet nga secila organizatë/ministri për përfaqësuesin e saj.

Qeveria kërkon rishikimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike

Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e 125-të, miratoi vendimin me të cilin obligohet Ministria e Energjisë dhe Minierave që në koordinim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave të themelojë dhe udhëzojë Grupin Punues për rishikimin dhe revidimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike. Ky grup do të jetë përgjegjës për të siguruar që modeli i propozuar i Tregut të Energjisë Elektrike të jetë në

përputhje me obligimet e Traktatit për Komunitetin e Energjisë, Strategjinë e Energjisë, të mundësojë projekte të ardhshme të gjenerimit dhe të mos krijojë pengesa për pjesëmarrjen e Kosovës në tregun rajonal të energjisë.

Modeli i propozuar i Tregut të Energjisë Elektrike, gjithnjë sipas këtij vendimi qeveritar, duhet të jetë model kalimtar, i cili siguron

zbatimin e suksesshëm të projektit “Termocentrali Kosova e Re” në pajtim me vendimin e Qeverisë nr. 7/99, të datës 17 dhjetor 2009. Si dhe për rikonfigurimin dhe shpalljen e Ftesës për Shprehjen e Interesit dhe të procesit të privatizimit të Kompanisë së Distribucionit dhe Furnizimit, siç parashihet në vendimin 8/39, të datës 8 tetor 2008.

Shtohet stafi i Departamentit të Trashëgimisë Kulturore

Themelimi i Departamentit të Trashëgimisë Kulturore i ka shtyrë zyrtarët e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit që t’i kërkojnë Qeverisë që të lejojë rritjen e stafit për 5 persona. Më herët, në kuadër të kësaj ministrie, ka funksionuar Divizioni i Trashëgimisë

Kulturore, mirëpo, në bazë të rekomandimeve të Këshillit të Evropës ky divizion është shndërruar në Departament. Ky vendim u morr në mbledhjen e 125-të të Qeverisë, me ç’rast Qeveria vendosi të aprovojë kërkesën e kësaj ministrie për

shtimin e personelit të këtij Departamenti për 5 pozita të reja, që janë: Drejtori i Departamentit, Udhëheqësi i Divizionit, Shefi i Sektorit, Administratori i bazës së të dhënave si dhe Asistenti Ekzekutiv.

DIPLOMATIC PASSPORT

Pasaportë diplomatike edhe për Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese

Siç kemi shkruar edhe në GAP Monitor 4, deri më 31 prill 2009, Ministria e Punëve të Jashtme kishte lëshuar 177 pasaporta diplomatike.

Në mbledhje e fundit për muajin maj, Qeveria ka marrë vendim të ndryshohet dhe plotësohet vendimi i Qeverisë Nr. 02/31 i datës 27 gusht 2008, i cili specifikon kategoritë e zyrtarëve që kanë të drejtë të pajisen me pasaporta diplomatike, të cilat lëshohen nga Ministria e Punëve të Jashtme. Neni 3.3 i atij vendimi thotë që pasaportat diplomatike i lëshohet edhe bashkëshortit/ës dhe fëmijëve deri në moshën 18 vjeçare, të: Kryetarit të Republikës së Kosovës; Kryetarit të Kuvendit; Kryeministrit; zëvendëskryeministrave; ministrave.

Ndërkaq, sipas vendimit të fundit të Qeverisë, neni 3.3. të vendimit të lartpërmendur duhet t'i shtohet edhe: Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.

Vitin e kaluar, më 8 prill 2009, Qeveria kishte marrë vendim që në listën e personave që kanë të drejtë të pajisen me pasaporta diplomatike të përfshihet edhe Shefi i Agjencisë Kosovare të Inteligjencës. Sipas Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit (Ligji Nr. 03/L-037), pasaportat diplomatike u jepen përfaqësuesve të misioneve diplomatike dhe personelit diplomatik si dhe zyrtarëve të tjerë të përcaktuar në nenin 10 të këtij ligji, kurse pasaportat zyrtare u jepen personelit teknik dhe administrativ të misioneve diplomatike në ambasada dhe konsullata si dhe zyrtarëve të tjerë të përcaktuar në nenin 11 të këtij ligji. Pasaportat

diplomatike pas përfundimit të mandatit dhe pasaportat zyrtare pas përfundimit të udhëtimit depozitohen në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Në rast se mbajtësi i pasaportës diplomatike apo zyrtare shkarkohet nga detyra, largohet nga puna apo emërohet në një detyrë tjetër, ai është i detyruar ta dorëzojë pasaportën diplomatike apo zyrtare. Afati i vlefshmërisë së këtyre lloj pasaportave nuk mund të jetë më shumë se 5 vjet. Siç kemi shkruar edhe në GAP Monitor 4, deri më 31 prill 2009, Ministria e Punëve të Jashtme kishte lëshuar 177 pasaporta diplomatike.

Rritje pagash prej 30 euro për shërbyesit civil

Ky fond, që do t'u ndahet të gjithë të kategorizuarve si nëpunës civil sipas Ligjit për Shërbimin Civil, kap shumën prej 5 milion euro në vit.

Në mbledhjen e 126-të, Qeveria morri vendim që nëpunësve civil t'ua rris pagat për 30 euro bruto. Ky fond, i cila do t'u ndahet të gjithë të kategorizuarve si nëpunës civil sipas Ligjit për Shërbimin Civil, kap shumën prej 5 milion euro e që do të ndahet nëpër linja buxhetore për secilën organizatë buxhetore. Megjithatë, kjo shumë prej 30 euro do t'u jepet nëpunësve civil vetëm për një periudhë tetë muajore, gjegjësisht nga 1 maji 2010 deri më 31 dhjetor 2010. Pra, ky vendim do të jetë në fuqi deri në fund të vitit 2010, ndërkohë

Qeveria ka obliguar Ministrinë e Administratës Publike që deri më 1 nëntor 2010 të përgatisë gjithë infrastrukturën e nevojshme për fillimin e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Civil dhe Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil, për të filluar së zbatuar nga 1 janari 2011. Deri atëherë nëpunësit civil duhet të kënaqën me këtë rritje prej 30 euro. Kosova ka gjithsej 14.746 punonjës me statusin e shërbyesit civil, ku sipas Ligjit për Shërbyesit Civil në këtë kategori hynë punonjësit e administratës së Kuvendit, Presidencës, Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive,

agjencitë ekzekutive, agjencitë e pavarura dhe ato rregullatore, si dhe administratat komunale. Gjithashtu, pjesë e Shërbimit Civil konsiderohet edhe personeli diplomatik dhe konsullor, si dhe personeli administrativ i dërguar jashtë vendit, ose i punësuar në MPJ; personeli civil i punësuar në Policinë e Kosovës, në FSK, në Doganat e Kosovës, në Shërbimin Korrektues të Kosovës; personeli i punësuar në sistemin gjyqësor dhe prokurorial. Për rregullimin e Pagave të Nëpunësve Civil kemi shkruar më gjerësisht në GAP Monitor 4.

Miratohet propozimi i MEF-it për heqjen e ndëshkimeve për borxhet tatimore

Vështirësitë e mëdha me të cilat po has Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), e kanë shtyrë këtë të fundit të mendojë për metoda tjera për vjeljen e borxhit tatimor nga kompanitë apo organizatat tjera. Evazoni i lartë fiskal që po i shkakton humbje të mëdha shtetit ka rezultuar në humbjen e besimit të bizneseve vendore dhe të huaja e sidomos të investitorëve potencial, pasi se evazoni fiskal përveç që e dëmton buxhetin e shtetit, e dëmton edhe konkurrencën e ndershme të atyre pak kompanive që i kryejnë obligimet ndaj shtetit.

Për këtë, në mbledhjen e 126-të, Qeveria ka miratuar propozimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave që të eliminojë politikat e ndëshkimit të bizneseve të cilat nuk i kanë kryer obligimet e tyre tatimore. Ky vendim do të vlejë për të gjithë tatimpaguesit që bëjnë pagesën e gjitha tatimeve dhe interesit të përlogaritur në lidhje me periudhat tatimore që përfundojnë më ose para 31 dhjetor 2008. Megjithatë, pagesat më këste nuk do të jenë të lejuara dhe se i gjithë tatimi dhe interesi obligativ për borxhet tatimore të pranueshme duhet të paguhet

me një pagesë të vetme të bërë gjatë periudhës për të cilën ky vendim është në fuqi. Lirimi nga borxhi tatimor përfshin të gjitha llojet e ndëshkimeve të të gjitha borxheve tatimore të papaguara gjatë periudhës së lartpërmendur, pa marrë parasysh kur është vlerësuar borxhi tatimor. Gjithashtu, për t'u kualifikuar për lirim nga ndëshkimet, është kusht që të paguhet të gjitha pagesat e tatimeve dhe të interesit pas datës së këtij vendimi, por jo më vonë se 30 nëntor 2010.

Ndryshohet dhe plotësohet Strategjia Legjislative 2010

Qeveria ka ndryshuar përsëri Strategjinë Legjislative 2010, e cila ishte miratuar me vendimin e Qeverisë nr. 2/101 të datës 30 dhjetor 2009. Që nga miratimi i këtij dokumenti shumë të rëndësishëm legjislative, Qeveria e Kosovës e ka ndryshuar dhe plotësuar atë 5 herë deri më tani. Strategjia fillestare e miratuar një ditë para përfundimit të vitit kalendarik 2009, kishte gjithsej 123 projektligje, ku prej tyre 65 ishin bartur nga SL'09! Pas këtyre 5 herëve sa është modifikuar Strategjia Legjislative, sot ajo ka 3 projektligje më shumë. Kështu, para këtij vendimi të fundit, SL'10 kishte gjithsej 127 projektligje, mirëpo ky numër u zbrit në 126 pasi se në mbledhjen e fundit të 26 majit, qeveria vendosi të shlyej nga kjo

strategji Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Veprimtaritë Kërkimore Shkencore, që ishte paraparë të miratohej më 30 nëntor 2010. Instituti GAP, në lidhje me këtë dokument strategjik, ka publikuar në shkurt të këtij viti analizën “Fakte rreth Strategjisë Legjislative”, ku janë shtjelluar ngecjet që qojnë në ndryshimin kaq të shpeshtë të këtij dokumenti, me ç'rast ka propozuar disa rekomandime se si duhet të evitohen këto gabime në të ardhmen. Për më shumë rreth kësaj analize, mund të lexoni në: (<http://institutigap.org/repository/docs/Fakte%20rreth%20strategjise%20legjislative.pdf>).

Miratohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit

Një ndër ndryshimet që janë bërë në projektligjin e ri është edhe plotësimi i nenit 2 që flet për përkufizimet ku tani e tutje i shtohet edhe ‘Libreza Detare’.

Ligji për Dokumentet e Udhëtimit, i hyrë në fuqi më 15 qershor 2008, duhet të ndryshohet për shkak të kërkesave për përputhjen e dispozitave ligjore në kuadër të plotësimit të kriterëve të përcaktuara nga Komisioni Evropian për liberalizimin e vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës. Megjithatë ligji në fuqi nuk është larg standardeve të kërkuara, pasi që potencon se institucionet relevante mund të lëshojnë pasaporta biometrike si një ndër kushtet në procesin e liberalizimit të vizave. Projektligji i ri i ndryshuar dhe plotësuar megjithatë koincidon me nevojën për plotësimin e kërkesave shtesë në këtë proces. Miratimi i këtyre ndryshimeve u bë në mbledhjen e 126-të të Qeverisë e cila u mbajt me 26 maj 2010.

Një ndër ndryshimet që janë bërë në projektligjin e ri është edhe plotësimi i nenit 2 që flet për përkufizimet ku tani e tutje i shtohet edhe “Libreza Detare”, e cila nënkupton dokumentin e udhëtimit të pajisur me

vizë që i lëshohet anëtarit të ekuipazhit të mjetit lundrues, e cila do të ketë periudhë të vlefshmërisë prej 2 viteve. Ndërkaq, në nenin 3 plotësimi është bërë në kuadër të pasaportës i cili thuhet që është dokument që i përmban të dhënat personale fizike dhe elektronike për dallim me ligjin e vjetër që thuhet se pasaporta është dokument publik dhe i jepet shtetasit të Republikës së Kosovës. Neni 12 po ashtu është plotësuar me dispozitën për mundësinë e qytetarëve të Kosovës për pajisje me pasaportë nga ambasadat/konsullatat e shtetit, gjë që nuk ishte specifikuar në ligjin e vjetër. Gjithashtu, sipas nenit 23, në lidhje me kërkesat për lëshimin e pasaportës ku përpos disa të dhënave që janë paraparë të përfshihen në formularin për lëshimin e pasaportës, është përcaktuar dhe dispozita ku thuhet se të gjitha të dhënat në dokumentet e udhëtimit të ruhen edhe në çip në formë elektronike duke përfshirë edhe gjurmët e gishtërinjve.



Përprojekje për integrimin e komunitetit RAE - themelohet Komiteti Drejtues Ndërinstitucional

Themelohet Komiteti Drejtues Institucional dhe Miratohet Plani Operativ - disa familje të komunitetit RAE pritet të bëhen me shtëpi

Në mbledhjen e saj të 126-të, Qeveria e Republikës së Kosovës morri vendimi për themelimin e Komitetit Drejtues Ndërinstitucional për mbikëqyrjen dhe koordinimin e zbatimit të Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Integrimin e Komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptas 2009 – 2015. Komiteti Drejtues do të jetë në këtë përbërje: Ramë Manaj (kryesues), Habit Hajredini (zëvendëskryesues), Enver Hoxhaj (anëtar), Mahir Yagcilar (anëtar), Bujar Bukoshi (anëtar), Srdjan Sentić (anëtar), Osman Osmani (anëtar), Muharrem Prizreni (anëtar), Seladin Dudaki (anëtar), një përfaqësues nga Këshilli Konsultativ për Komunitete (anëtar) dhe një përfaqësues nga Avokati i Popullit (anëtar). Ky komitet do të

kryej detyrat dhe përgjithësitë e përcaktuara me Planin e Veprimit për zbatimin e Strategjisë për integrimin e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas 2009-2015 të miratuara nga Qeveria e Kosovës. Kjo strategji është miratuar në dhjetor të 2008 ndërsa Plani i Veprimit i kësaj strategjie në vitin 2009.

Po në të njëjtën mbledhje Qeveria ka marrë edhe një vendim që ka të bëjë me banorët e këtij komuniteti dhe i cili bazohet po në Strategjinë për Integrimin e Komuniteteve RAE. Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi planin operativ për vendosjen e familjeve Romë, Ashkali dhe Egjiptas, të zhvendosura brenda vendit, nga kampet e kontaminuar me plumb, Osterode dhe Lugu i Qeshmës. Ky projekt parasheh

që deri në fund të vitit 2010 të ndërtohen 140 shtëpi për këto familje që jetojnë në këto kampe. Ndërsa, komuna e Mitrovicës për këtë qëllim ka ndarë 7 ha tokë nga prona komunale. Projekti është në fazën e parë të ndërtimit të 52 shtëpive që përkrahen financiarisht nga USAID, përderisa implementues i projektit është Mercy Corps. Në të njëjtën kohë po punohet me Grupin Punues që disa qytetarë të qytetit të Mitrovicës nga kampet të kthehen në vendin e origjinës, në disa lagje të Mitrovicës. Për kthim të qytetarëve nga kampet në këto shtëpi do të ketë një përkujdesje socio-ekonomike derisa ata të integrohen në jetën e përditshme, përfshirë edhe trajnime të ndryshme për aftësimin e tyre për punë në profile të ndryshme.

Miratohet Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave

Në mbledhjen e 126-të, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Emergjencave (SIME). Ky sistem ofron kornizë të qëndrueshme gjithëkombëtare për të mundësuar që qeveritë e të dyja niveleve, organizatat joqeveritare (OJQ-të) dhe sektori privat, të punojnë së bashku për parandalimin, mbrojtjen, reagimin, rimëkëmbjen dhe zvogëlimin e efekteve të incidenteve pa marrë parasysh shkakun, madhësinë, vendndodhjen apo kompleksitetin e tyre. Kjo qëndrueshmëri ofron

bazament për përdorimin e sistemit për të gjitha incidentet duke filluar nga ndodhitë e përditshme deri tek incidentet që kërkojnë reagim të koordinuar qeveritar. Me këtë vendim obligohen të gjitha institucionet qendrore që ta adoptojnë SIME-në dhe ta përdorin në programet dhe aktivitetet e tyre individuale të menaxhimit të incidenteve, si dhe në të gjitha veprimet e ndërmarra për mbështetjen e nivelit lokal të qeverisjes.

Miratohet Projektligji për themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare në Kosovë


Megjithëse sektori financiar në vend konsiderohet si njëri ndër sektorët më të konsoliduar, prapëseprapë është ndier nevoja që ky sistem të përmirësohet dhe të jetë në gjendje që t'i përballojë sfidat ekonomike që mund të dalin në të ardhmen. Për këtë qëllim, është ndier e nevojshme që depozituesve të vegjël t'u garantohen mjetet e tyre që i kanë të depozituara në bankat komerciale në raste të falimentimit të këtyre të fundit. Këto masa janë paraparë të ndërmerren në kuadër të Ligjit për Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare në Kosovë. Ky projektligj u miratua në mbledhjen e 125-të të Qeverisë, të mbajtur më 18 maj 2010.

Me këtë projektligj synohet të rregullohet siguri i depozitave të personave fizik dhe juridik, themelimi, qeverisja, autoriteti i Fondit të Sigurimit të Depozitave në Kosovë si dhe mbikëqyrja e likuidimit të Institucioneve Financiare në Kosovë. Përmes këtij projektligji synohen të arrihen dy objektiva:

- Objektivi primar është mbrojtja e depozituesve të vegjël nga humbja në rast të paraqitjes së një ngjarjeje të pavolitshme për konsumatorët e Institucioneve Financiare dhe;

- Objektivi sekondar është mbështetja e BQK-së në arritjen e qëllimit të saj në rritjen e sigurisë, solvencës dhe funksionimit efikas të një sistemi stabil, të bazuar në ekonominë e tregut.

Në nenin 5, ku flitet për limitet e sigurimit të depozitave, thuhet që çdo personi fizik dhe juridik duhet të rimbursohet deri në nivelin prej 2000 euro, përfshirë këtu interesin e mbledhur deri në atë datë kur ka ndodhur ngjarja. Mundësia për realizimin e rimbursimit për këta depozitues të vegjël do të bëhet e mundur përmes themelimit të Fondit të Sigurimit të Depozitave, ku çdo institucion financiar që operon në tregun e Kosovës është i obliguar që të anëtarësohet duke paguar një premium fillestar, vetëm një herë, prej 0.3% të fondeve të kapitalit fillestar. Kapitali i autorizuar i Fondit do të jetë 15 milion euro të cilat do të sigurohen nga donacionet e ndryshme apo kontributet fillestare. Burimet plotësuese të kapitalit mund të përfshijnë të hyrat nga premiumet, të hyrat nga shitja e aseteve dhe kthimin në investime.



Miratohet Rregullorja për themelimin e Zyrës për të Drejtat për Pronën Intelektuale

U deshën plotë 6 vite për të vënë në zbatim dispozitën ligjore, gjegjësisht nenin 169 (1) të Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat tjera të përafërta. Ky ligj është miratuar nga Kuvendi në vitin 2004. Në nenin 169 (1) të këtij ligji thuhet që “Qeveria e Kosovës do të themelojë Zyrën për të Drejtat mbi Pronën Intelektuale **brenda 18 muajsh nga shpallja e këtij ligji**”!

Megjithatë, Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e saj të rregullt të 126-të, të mbajtur më 26 maj 2010, morri vendim për miratimin e Rregullores për themelimin e Zyrës për të Drejtat për Pronën Intelektuale. Akterët që janë marrë me hartimin e kësaj rregulloreje kanë bërë dhe një lëshim tjetër teknik pasi që ky vendim ashtu siç thuhet nga Qeveria, është marrë duke u bazuar në nenin 168 (1) e që nuk është e saktë pasi në ligjin në fjalë në të cilin është bazuar kjo rregullore, neni 169 (1) është dispozita ku kërkohet të themelohet kjo Zyre. Sidoqoftë, kjo zyrë do të zhvilloj fushëveprimin e vet në fusha si:

- Certifikimi i asociacioneve të autorëve dhe bartësve të tjerë të të drejtave si dhe subjekteve tjera ligjore të specializuara në administrimin e të drejtave të autorit;
- Anulimi i këtyre certifikimeve në raste të mospërbushjes së kriterëve të caktuar konform ligjit;
- Mbikëqyrja e aktiviteteve të asociacioneve kolektive;
- Përgatitjen e legjislacionit mbi kriteret që i referohen këtij Ligji, etj.

Si pjesë e punës së kësaj Zyre do të jetë po ashtu promovimi, informimi dhe ndërmarrja e aktiviteteve për vetëdijesimin e opinionit të gjerë, autorëve dhe bartësve të të drejtave të autorit. Gjithashtu, kjo zyrë do të organizojë programe trajnimi, seminare, tryeza, debate publike me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale për zbatimin në praktikë të Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat tjera të përafërta.

Miratohet plotësim – ndryshimi i Strategjisë për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar

Sipas statistikave zyrtare, deri në 5000 persona janë riatdhesuar me forcë brenda një viti.

Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e saj të 126-të, miratoi plotësimin – ndryshimin e Strategjisë për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar. Ri-integrimi i personave të riatdhesuar vjen si rrjedhojë e procesit të riatdhesimit dhe si i tillë paraqet një ndër sfidat me të cilat po ballafaqohet Kosova që nga pas lufta. Numri i kosovarëve të cilët kanë lëshuar Kosovën më herët, gjatë dhe pas luftës, ka qenë i konsiderueshëm dhe si pasojë shtetet tjera, posaçërisht shtetet e BE-së, nuk kanë qenë në gjendje t’iu ofrojnë vendbanim të përhershëm apo të përkohshëm. Leja e vendbanimit, qëndrimit apo qëndrimit të ligjshëm, iu është refuzuar një numri të konsiderueshëm të njerëzve nga kjo kategori, ku si pasojë është vendosur që këta persona të riatdhesohen.

Sipas statistikave zyrtare, deri në 5000 persona janë riatdhesuar me forcë brenda një viti. Përgjegjësia për ri-integrimin e personave të riatdhesuar ka qenë deri vonë e UNMIK-ut, UNHCR-së, IOM-it dhe organizatave tjera që kanë shqyrtuar këto raste. Sidoqoftë, në vitin 2006 kjo përgjegjësi iu është transferuar institucioneve kosovare, respektivisht Bordit Ekzekutiv i cili menaxhon implementimin e Strategjisë dhe Planit Veprues për ri-integrimin e personave të riatdhesuar. Përgjegjës për zbatimin e kësaj Strategjie dhe Planit të Veprimit kanë qenë: MPB, MPMS, MAPL, MSH, MASHT, MAPH e po ashtu edhe Agjensioni Kosovar i Pronës për çështjet e lidhura me pronë.

Për këtë arsye dhe për t’u siguruar që personat e zhvendosur të kenë tretman të mirë pasi të riatdhesohen, Bordi Ekzekutiv ka vendosur të vlerësojë mekanizmin e tanishëm për ri-integrim. Vlerësimi është bërë në bashkëpunim me akterët vendor dhe ndërkombëtarë. Disa nga rekomandimet e dala pas vlerësimit janë:

- Përpilimi dhe aprovimi i ligjit për riatdhesim;
- Ndryshimi i strategjisë dhe plan veprimit për ri-integrimin e personave të riatdhesuar duke siguruar që rekomandimet nga ky vlerësim të merren parasysh;
- Negocimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale për riatdhesim me BE-në (në bllok) apo individualisht me shtetet anëtare të BE-së;
- Themelimi i fondit për ri-integrimin e personave të riatdhesuar, fond ky i cili përbëhet nga buxheti i Kosovës dhe donatorët e mundshëm;
- Ndërtimi i kapaciteteve fizike dhe njerëzore në nivel qendror dhe lokal për të adresuar në mënyrë sa më efektive këtë proces;
- Përmirësimi i komunikimit dhe koordinimit ndër-institucional në nivel qendror dhe lokal me qëllim të eliminimit të defekteve/mungesave;
- Komunikim i përmirësuar me shtetet kërkuuese, në veçanti shkëmbimi bilateral i informatave mbi personat potencial për riatdhesim.

Procesi i ri-pranimi dhe i ri-integrimit është mjaftë i rëndësishëm që ndikon edhe në procesin e liberalizimit të vizave.

Përmbledhje

Më poshtë janë të radhitura të gjitha vendimet e marra nga Qeveria gjatë muajit maj 2010, ashtu siç janë marrë në formë kronologjike (mbledhjet 124-126):

Vendimet nga mbledhja e 124-të e Qeverisë së Kosovës, mbajtur më 13 maj 2010:

1. Vendim 02/124, miratohet Projektligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës;
2. Vendim 03/124, miratohet Projektligji për Qasje në Dokumente Publike;
3. Vendim 04/124, miratohet kërkesa për shpronësimin e pronave të paluajtshme në rrugën M9 nga Fushë Kosova deri në Arllat, rrugën M2 nga Prishtina deri në Mitrovicë dhe ngastrën 7497 sipas fletës poseduese Nr. 6590 në zonën kadastrale në Prishtinë;
4. Vendim 05/124, Qeveria e Republikës së Kosovës në cilësinë e ushtruesit të ligjshëm të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës në Ndërmarrjen Publike "Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A" ("PTK"), vendos se Ministri për Ekonomi dhe Financa (Ministri), në rolin e tij si Kryesues i Komisionit Ndër-Ministror për NP, autorizohet dhe urdhërohet të veprojë në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si aksionar i vetëm në PTK, dhe të ndërmarrë të gjitha masat e ligjshme, të nevojshme dhe të përshtatshme të aksionarit për realizimin e veprimeve ku PTK-ja dhe Bordi i saj i Drejtorëve menjëherë të deklarojnë dhe paguajnë një dividendë ("Dividenda") për aksionarin në shumën prej 80 milion euro;
5. Vendim 06/124, Qeveria rekomandon Autoritetin Rregullativ të Telekomunikacionit të Republikës së Kosovës që të mos jap licencë për operatorin e tretë të telefonisë mobile në Kosovë për pesë vitet e ardhshme;
6. Vendim 07/124, aprovohet kërkesa e Ministrisë së Energjisë dhe Minierave për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 160 mijë euro për fillimin e themelimit të Njesisë për Menaxhimin e Projektit "Hidrocentrali Zhur" dhe Këshilltarëve të Transaksionit;
7. Vendim 08/124, Qeveria e Republikës së Kosovës për anëtar të Bordit Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit i rekomandon Kuvendit këta kandidatë: Behxhet Mustafa, Sylejman Berisha, Kemail Bislimi, Nysrete Doda – Gashi, Tush Markaj dhe Luan Shllaku;
8. Vendim 09/124, Qeveria e Republikës së Kosovës për anëtarë të Këshillit për Planifikim Hapësinor emëron këta kandidat: Ruzhdi Pllana; Ylber Vokshi, Ilir Gjinolli, Laura Kusari-Limaj, Xhelal Llonçari, Dervish Qerreti dhe Adem Pajaziti;
9. Vendim 10/124, ndahen mjete financiare në shumë prej 11.000 euro për mbulimin e shpenzimeve për shoqatën e matematikanëve të Kosovës;
10. Vendim 11/124, aprovohet kërkesa e deputetit z. Ali Lajçi për mbulimin e shpenzimeve të shërimit.

Vendimet nga mbledhja e 125-të e Qeverisë së Kosovës, mbajtur më 18 maj 2010:

1. Vendim 1/125, miratohet projektligji për themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare në Kosovë;
2. Vendim 2/125, miratohet Projektligji për Prokurorinë e Shtetit;
3. Vendim 3/125, miratohet Projektligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës;
4. Vendim 4/125, miratohet kërkesa e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për shpërndarjen e mjeteve të planifikuara për programin 'Universiteti i Prizrenit', në vlerë prej 2 milion euro;
5. Vendim 5/125, aprovohet Plani Zhvillimor për Universitetin e Prizrenit;
6. Vendim 6/125, themelohet Komisioni Kombëtar për Refugjatë;
7. Vendim 7/125, obligohet Ministria e Energjisë dhe Minierave që në koordinim me Ministrinë për Ekonomi dhe Financa ta themeloj dhe udhëzojë Grupin Punues për rishikimin dhe revidimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike;
8. Vendim 8/125, aprovohet kërkesa e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për rritjen e stafit shtesë për themelimin e Departamentit të Trashëgimisë Kulturore për pesë pozita të reja;
9. Vendim 9/125, Qeveria i propozon Kuvendit tre kandidatë për kryetar dhe anëtarë të Komisionit Rregullativ të Prokurimit;

Vendimet nga mbledhja e 126-të e Qeverisë së Kosovës, mbajtur më 26 maj 2010:

1. Vendim 2/126, miratohet, me ndryshime, Udhëzimi për Nënshkrimin e Kontratave Publike me Vlerë të Mesme dhe Vlerë të Madhe;
2. Vendim 3/126, miratohet Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-037 për Dokumentet e Udhëtimit;
3. Vendim 4/126, miratohet Plotësimi dhe Ndryshimi i Strategjisë për Riatdhesimin e Personave të Riatdhesuar;
4. Vendim 5/126, miratohet me ndryshime Rregullorja për themelimin e Zyrës për të Drejtat për Pronën Intelektuale;
5. Vendim 6/126, miratohet propozimi i MEF për heqjen e ndëshkimeve të caktuara për borxhet tatimore;
6. Vendim 7/126, miratohet Plani operativ për vendosjen e familjeve Romë, Ashkalinj dhe Egjiptas të zhvendosur brenda vendit, nga kampet e kontaminuara me plumb, Osterode dhe Lugu i Qeshmës;
7. Vendim 8/126, themelohet Komiteti Drejtues Ndërinstitucional për Mbikëqyrjen dhe Koordinimin e zbatimit të Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Integrimin e Komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptas 2009-2015;
8. Vendim 9/126, nga Strategjia Legjislative për 2010 hiqet Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Veprimtarinë Kërkimore Shkencore;
9. Vendim 10/126, ndryshohet dhe plotësohet vendimi i Qeverisë nr.02/31 i datës 27 gusht 2008, për zyrtarët e lartë publik që kanë të drejtë të pajisen me pasaporta diplomatike;
10. Vendim 11/126, të gjithë të kategorizuarit si nëpunës civil sipas Ligjit për Shërbyes Civil të miratuar nga Kuvendi i Kosovës do të përfitojnë mjete financiare në bazë mujore, në vlerë prej 30 Euro bruto;
11. Vendim 12/126, miratohet Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave.

gap monitor

i vendimeve të Qeverisë së Kosovës

Rr. Nëna Terezë 41/29
10000 Prishtinë, Kosovë
+381 38 224 145
monitor@insitutigap.org
www.institutigap.org

"GAP Monitor" është projekt i Institutit për Studime të Avancuara GAP në të cilin monitorohen vendimet e Qeverisë së Kosovës. Projekti i "GAP Monitor" ka filluar në janar të 2009, ku përmes publikimeve të përmuajshme Instituti GAP i ofron publikut informata dhe analiza më të thella për të gjitha vendimet e Qeverisë së Kosovës. Tani, projektit të "GAP Monitor" është shtuar edhe faqja e re në internet, e cila na mundëson interaktivitet më të madh me lexuesit si dhe mundësinë për të publikuar lajme dhe analiza në kohë më të shpejtë.


INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA



Instituti GAP është Think Tank kosovar, që punon në ngushtimin e hendekut në mes qeverisjes dhe qytetarëve të Kosovës, në shërbim të avancimit të shoqërisë kosovare.

Të gjitha raportet për vendimet e Qeverisë mund të gjenden edhe në portalin e GAP Monitor në internet
www.gapmonitor.org

Instituti për Studime të Avancuara GAP
përkrahet nga:



Projekti i GAP Monitor
përkrahet nga:

Opinionet e shprehura në këtë dokument janë ato të Institutit GAP dhe jo medoemos reflektojnë pikëpamjet e donatorëve të këtij projekti.